



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Neni 19.3.1 i PFV-ve, pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive në ministri. Auditimi ka nxjerrë në pah se pesë (5) pagesa në vlerë totale prej 1,000,285€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Në anën tjetër, ministria vazhdon t'i ketë të regjistruara ende si investime në vijim pasurit në vlerë prej 476,887€, edhe pse projektet kapitale kishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre.
- A1 Si rezultat i obligimeve kontraktuale për pagesën e qirasë për objektin të cilin MKRS nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë, me datën 30/12/2021 ishin realizuar pagesa bazuar në vendim gjyqësor në vlerë 481,651€ prej tyre 415,678€ në emër të borxhit kryesor dhe 65,973€ kosto shtesë (shpenzimet e përmbarimit dhe kamatës).
- B2 Gjatë vitit 2021, MKRS kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 21,088€ në kategori ekonomike jo adekuate.
- B3 Për 20 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrojtja civile", MKRS-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të konfirmuar vijueshmërinë në punë. Shpenzimet e pagave gjatë vitit 2021 për të punësuarit e lartë cekur ishin 100,264€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit.

Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- C1 Ministria në fund të vitit 2021 kishte avanse të hapura për udhëtime zyrtare në vlerë 19,267€, për të cilat zyrtarët përgjegjës ende nuk kishin sjellë dëshmitë përkatëse për mbylljen dhe arsyetimin e tyre.
- A2 MKRS në tri raste kishte lidhur kontrata përmes procedurave jo adekuate të prokurimit.
- A3 Ministria kishte përmbledhë aktivitete të cilat për nga natyra nuk ishin të njëjta apo të ngjashme me një procedurë të vetme të prokurimit, në vlerë të parashikuar prej 600,000€.
- B4 Në shtatë (7) raste në vlerë prej 41,145€ nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohet me marrëveshje.
- B5 Në 16 raste pagesat në vlerë 1,200,117€ ishin realizuar pas afatit kohorë ligjorë prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga 28 deri 682 ditë.
- B6 Në pesë (5) raste në vlerë 53,870€, kemi vërejtur se kishte mangësi në procedimin e pagesave pasi që në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i MKRS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i MKRS është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga

gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Në kontekst të sistemeve financiare, duhet të forcohen kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë fusha e subvencioneve si fushë më shqetësuese për shkak të moszbatimit të kërkesave ligjore gjatë dhënies së tyre, pastaj menaxhimi i pasurisë, prokurimi si dhe pagesa e obligimeve.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive

Gjetja

Sipas nenit 6.3 të rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare – Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Po ashtu, neni 11.3 përcakton se - Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) e prezantuar në PFV nuk paraqet vlerën e saktë të pasurive të ministrisë. Auditimi ka nxjerrë në pah se pesë⁴(5) pagesa në vlerë prej 1,000,285€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Në anën tjetër, ministria vazhdon t'i ketë të regjistruara ende si investime në vijim pasuritë në vlerë totale prej 476,887€⁴, projekte kapitale të cilat kishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare ndikon në prezantim jo të drejt të pasurive në PVF dhe pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë me rrezikun që pasuritë të humbin apo keqpërdoren.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Pagesa e Qirasë për objektin/hapësirën e pashfrytëzuar nga MKRS

Gjetja

Ministria kishte lidhur kontratë me një operator ekonomik për shfrytëzimin e një objekti/hapësire me qira duke filluar nga data 17.09.2019. Sipas nenit 3.1 të kontratës çmimi të cilin duhet të paguajë MKRS për shfrytëzim të objektit do të jetë 45,000€ në muaj për 2,500m². Ndërkaq sipas nenit 4 kohëzgjatja e kontratës do të jetë për një periudhë 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi. Kontrata mund të ndërpritet edhe më herët nga të dyja palët me një njoftim paraprak prej së paku një muaj.

Ministria edhe pse nuk e kishte shfrytëzuar këtë objekt, nuk kishte ndërmarr asnjë hap deri me dt.11.08.2020 kur kishte marrë vendim për shkëputje të kësaj kontrate.

Dhe si rezultat i mos kryerjes së obligimeve nga Ministria, OE kishte dërguar lëndën tek përmbaruesi privat. Bazuar në vendimin përmbarimor Thesari me dt.30.12.2021 kishte realizuar pagesën në vlerë 481,651€ (415,678€ borxh kryesor dhe 65,973€ shpenzime të përmbarimit dhe kamatës).

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Realizmi i pagesave për objektin/hapësirën e cila nuk është shfrytëzuar fare nga MKRS ka ndikuar në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj se janë trajtuar të gjitha kërkesat për lidhjen e kësaj kontrate si dhe mosshfrytëzimit të saj, po ashtu, të trajtojë shkaqet e mos ndërmarrjes me kohë të veprimeve nga zyrtarët kompetent për shkëputjen e kontratës. Më tutje, të ndërmarrë veprimet e nevojshme konform kërkesave ligjore në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten rastet e tilla.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

MKRS gjatë vitit 2021 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 21,088⁵€ në kategori ekonomike jo adekuate. Këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, ndërsa ishin paguar/regjistruar në kategorinë subvencione dhe transfere.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoria ekonomike jo adekuate ka ndikuar në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar Informata të gabuara për lexuesin.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestিনি i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë

Gjetja Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se -“Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik“.

Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr.06/39 i dt. 22.07.2015, 20 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrojtja civile" ishin caktuar në departamente të ndryshme të MKRS-së në veri të vendit. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë hapësira të përcaktuara të punës dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2021 ishte 100,264€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi po raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerri masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi

Pagesat e pagave në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit, si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara në marrëveshje dhe mos integrim të këtij komunitetit në sistemin aktual.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të ndërmerri të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja C1 - Vonesa në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare

Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2004/07 për Shpenzimet e Udhëtimeve Zyrtare, të gjitha avanset duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi.

Në një rast avansi i dhënë për udhëtim zyrtar në Francë me datën 06.07.2021 në vlerë 2,673€, nuk ishte arsyetuar dhe mbyllur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar, mbyllja e tij ishte bërë me 22.02.2022.

Për më tepër në ministri kishte avanse të hapura që nga viti 2010 për të cilat zyrtarët përgjegjës ende nuk kishin sjellë dëshmitë përkatëse për mbylljen përkatësisht arsyetimin e tyre. Vlera e avanseve të paarsyetuara deri në fund të vitit 2021 ishte 19,267€.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos ndërmarrjes së veprimeve ligjore nga menaxhmenti i ministrisë ndaj zyrtarëve përfitues për kthimin e mjeteve.

Ndikimi

Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve dhe mos mbyllja e avanseve, rritë rrezikun që paratë publike të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara, rregullat e aplikueshme apo të keqpërdoren.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avanset për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, të ushtrijë padi gjyqësore kundër të gjithë zyrtarëve të cilët nuk kanë arsyetuar shpenzimet e udhëtimit zyrtar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Lidhja e kontratës përmes procedurës jo adekuate të prokurimit

Gjetja

Neni 35 i LPP-së përcakton që procedura e negociuar mund të përdoret për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e: çfarëdo kontrate publike: (iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Lidhur me këtë, kemi identifikuar si në vijim:

- Për projektin “Kisha katolike në Ferizaj” fillimisht ishte aplikuar procedura e hapur e prokurimit, pas ankesave nga operatorët ekonomik sa i përket kriterëve të vendosura, KRPP-ja kishte dhënë rekomandim për ndryshimin e këtyre kriterëve. Përkundër që

Ministria kishte ndryshuar kriteret ky aktivitetit ishte anuluar me datën 22.11.2021. Më tutje, ministria kishte vazhduar me procedurë të negociuar e cila ka rezultuar me lidhjen e kontratës me datë 23.12.2021 në vlerë 473,363€, duke u thirrur në nevojën për riparime urgjente në këtë objekt. Megjithatë ministria nuk ka ofruar ndonjë dëshmi (procesverbal apo raport) nga komisioni përkatës/Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore i cili ka bërë verifikimin e gjendjes faktike dhe ka konstatuar nevojën për riparime emergjente.

- Po ashtu tek dy projekte⁶ gjatë ekzekutimit të kontratave ishte paraqitur nevoja për punë shtesë të cilat e kanë tejkaluar 10% të vlerës së kontratës bazë. MKRS për këto dy projekte kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit duke përdorur procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë dhe kishte lidhur kontratë me operatorët e njëjtë.

Mangësitë e identifikuar më lartë kanë ndodhur si pasojë e mos monitorimit dhe planifikimit jo të mirë të projekteve.

Ndikimi

Kontraktimi përmes procedurës së negociuar mund të ndikoj në zvogëlimin e konkurrencës dhe diskriminimin e ofruesve tjerë të shërbimeve të tilla, si dhe mund të rezultojë me një kosto më të lartë të shpenzimeve sesa çmimet e konkurrencës.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë aplikimin e procedurave adekuate të prokurimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve, dhe njëherësh të sigurohet që në rastet kur përdoret procedura e negociuar të sigurohen dëshmitë përkatëse që mbështesin përdorimin e një procedure të tillë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Përmbledhja e aktiviteteve të ndryshme në një procedurë të vetme të prokurimit

Gjetja

Sipas nenin 5.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik, AK për të planifikuar aktivitetet e prokurimit duhet të mbledhë kërkesat, kur është e mundshme (të njëjta ose të ndërlidhura), për të fituar vlerën për parandë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.

Megjithatë, tek aktiviteti i prokurimit "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentare për nevojat e MKRS-së", janë përfshirë disa akitivtete të rregullta të ministrisë të cilat për nga natyra nuk ishin të njëjta apo të ngjashme (Akomodim, transport, përkthim, pajisje për zërim, mirëmbajtja e rrjeteve sociale, prodhim i spoteve Tv, furnizime të ndryshme broshura, lapsa, maica me llogo, çanta etj). Për më tepër, në këtë aktivitet të prokurimit ishin përfshirë edhe disa shërbime të cilat janë të përjashtuara me nenin 3 të LPP-së Nr.04/L-042 si: Kokteji i hapjes së ekspozitave (ushqimi dhe pijet), qiraja etj.

Kjo ka rezultuar me lidhjen e kontratës me datë 22.02.2021 në vlerën e parashikuar 600,000€ në kohëzgjatje 36 muaj, me një operator ekonomik i cili nuk ka veprimtari përkatëse për kryerjen e të gjitha këtyre aktiviteteve⁷.

Kjo ka ndodhur pasi që ZKA kishte mbledhur kërkesat nga departamentet përkatëse dhe kishte iniciuar aktivitetin e prokurimit pa bërë ndonjë analizë të duhur sa i përket natyrës së shërbimeve/ furnizimeve.

Ndikimi

Përfshirja në një aktivitet të prokurimit e kërkesave të ndryshme për shërbime /furnizime të cilat për nga natyra nuk janë të njëjta apo të ngjashme rrit rrezikun e mos kryerjes së tyre në mënyrë profesionale dhe me kosto jo konform kushteve të tregut.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të prokurimit me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera (njësitë kërkuese) për të diskutuar kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri, në mënyrë që vetëm kërkesat e arsyeshme të njëjta apo të ngjashme mblidhen në një aktivitet të prokurimit për të fituar vlerën për parane dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në arsyetimin e subvencione

Gjetja

Ministria me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të kulturës në përgjithësi, përveç tjerash, bënë edhe subvencionimin e projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive, qoftë të entiteteve publike apo atyre jo publike. Subvencionet jepen në formë të avanseve me qëllim që të njëjtat të arsyetohen në fund dhe të mbyllen. Sipas marrëveshjeve të nënshkruara, me rastin e dhënies së subvencioneve, bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara, në afat prej 30 ditësh pas realizimit të aktiviteteve të subvencionuara.

Nga mostrat e testuara identifikua se në shtatë⁸ raste në vlerë totale prej 41,145€, përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve, të cilat sipas marrëveshjeve duhej të kishin përfunduar.

Ministria kishte subvencione të paarsyetuar që nga viti 2015.

Kjo ishte si pasojë e menaxhimit jo të mirë të procesit të dhënies së subvencioneve si dhe mungesës së mekanizmave adekuat që do t'i kushtëzonte përfituesit që të raportojnë për projektet e subvencionuara.

Ndikimi

Numri i madh i projekteve të paarsyetuara bën të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë dhe vlera për para është arritur. Mos arsyetimi dhe raportimi për projektet e subvencionuara, mund të dëmtojnë buxhetin e ministrisë dhe rrisin mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja

Neni 39.1 i LMFP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim. Ndërsa neni 24, paragrafi 1.3 i rregullores Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, përcakton se: - Të gjitha faturat duhet të protokollohen dhe evidentohen në librin e faturave.

Në 16 raste faturat në vlerë totale prej 1,200,117€ nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjorë. Vonesat variojnë nga 28 deri 682 ditë.

Ndërsa në nëntë (9) raste identifikuam se faturat në vlerë totale prej 855,954€ nuk ishin evidentuar në librin e protokollit nga ministria.

Kjo ka ndodhur pasi që MKRS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit dhe pagesës së faturave, ngase faturat e pranuar nuk protokollohen dhe nuk evidentohen në librin e faturave.

Ndikimi

Vonesat e pagesave ndaj furnitorëve dhe mos zbatimi i procedurave të kontrollit me rastin e pranimit të faturave që kanë të bëjnë me protokollimin dhe evidentimin e tyre në librin e faturave, ndikojnë që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që ministria duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraprak. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari që njëkohësisht reflektohet me kosto shtesë.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Neni 22 i Rregullës Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, përcakton që: - Fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në pesë raste në vlerë 53,870€, kemi vërejtur se në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të procedurave ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë me vonesa në realizimin e pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për periudhat vijuese.

Rekomandimi B6 Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 16,862,356€, prej tyre ishin shpenzuar 15,439,950€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimin e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Çështja A4 - Mangësi në procesin e vlerësimit të subvencioneve

Gjetja

Sipas neni 16 pika 1.1 të rregullores nr. 04/2017 mbi Kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, - Komisioni i vlerësimit duhet të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural, pika 1.2.- Komisioni i vlerësimit të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet/propozimet e aplikantëve të kualifikuara për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor, si dhe neni 18.4 thotë që aplikantët të cilët marrin më pak se pesëdhjetë (50) pikë nuk mund të përfitojnë mbështetje financiare në asnjë rast.

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Tek thirrja publike e datës 18.08.2021 – Pakoja e ringjalljes ekonomike - në një rast komisioni i vlerësimit nuk kishte vlerësuar aplikacionin në përputhje me kërkesat e rregullores pasiqë formulari i vlerësimit (poentimit) të projektit nuk ishte nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit por vetëm nga njëri prej tyre. Në këtë rast përfitues i subvencionit në vlerë 121,430€ ishte një OJQ, për projektin “Databaza Sportive në Kosovë”.

Kjo ka rrjedhur si rezultat i limiteve kohore në procedurën e vlerësimit dhe ndryshim plotësimet e shpeshta të komisionit të vlerësimit. Në këtë thirrje publike kanë përfituar gjithsejtë 181 OJQ ndërsa afati kohorë për vlerësim ishte gjithsej 4 dite (2 ditë pune dhe 2 ditë vikend).

- Tek thirrjet publike “Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçje në tregun e punës” (dt.13.04.2021) dhe “Pakoja e ringjalljes ekonomike” (dt.16.08.2021), komisionet e vlerësimit kishin bërë vlerësimin përmbajtësor të projekteve dhe poentimin e tyre vetëm për aplikantët të cilët kishin plotësuar kriteret formale të thirrjes publike. Pas përfundimit të vlerësimeve dhe raportimit të listës preliminare palët e pa kënaqura kanë parashtruar ankesë në MKRS. Në 11 raste kemi vërejtur se komisioni i ankesave kishte shqyrtuar ankesat e aplikantëve, mirëpo nuk kishte bërë vlerësimin formal përmbajtësor të projekteve (plotësimin e formularit – poentimin) për tu siguruar që aplikantët marrin më tepër se 50 pikë për tu kualifikuar për mbështetje financiare. Pra mbështetja financiare ishte bërë pa qenë të sigurt se projektet kanë mbi 50 pikë.

Kjo kishte ndodhur në mungesë të një udhëzuesi të brendshëm për sqarimin e hapave të mëtutjeshëm për vlerësimin e projekteve pas shqyrtimit të ankesave nga komisioni përkatës.

Ndikimi Mos vlerësimi i projekteve nga aspekti përmbajtësor rrit rrezikun e përkrahjes së projekteve jo cilësore të cilat nuk përmbushin kriterin për subvencionim dhe njëherësh të mos arrihen objektivat e përcaktuara nga ana e ministrisë.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që komisionet e vlerësimit i përmbahen kërkesave të legjislacionit përkatës me rastin e vlerësimit të aplikacioneve si dhe të bëj hartimin e një dokumenti të brendshëm i cili qartëson procedurën e vlerësimit të projekteve (poentimin) pas shqyrtimit të ankesave nga komisioni për rastet të cilat i kanë plotësuar kriteret për thirrje publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,042,810€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 9,128,081€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore etj.

Çështja A5 - Ndarje jo e drejtë e detyrave

Gjetja Neni 62.3 pika 4 i rregullave dhe UOPP përcakton që - Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, nuk mund të nënshkruajë për asnjë nga artikujt e mësipërm 1 ose 2, as nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit.

Tek procedura e prokurimit “Rregullimi dhe meremetimi i shkallëve dhe platos rreth BKK-së”, zyrtari i cili kishte përgatitur specifikimet teknike ishte anëtar në komisionin e vlerësimit si dhe anëtar në komisionin e pranimit teknik. Kontratë është nënshkruar me dt.24.09.2021 në vlerë prej 19,326€.

Ndarja jo e drejtë e detyrave ishte rezultat i kujdesit të pamjaftueshëm të menaxhmentit në parandalimin e konfliktit të detyrave.

Ndikimi Kontrollat jo efektive kanë mundësuar përfshirjen e zyrtarit të njëjtë në tri faza të procesit, kjo është në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave si konflikt interesi dhe/apo kërcënim të objektivitetit gjatë përbushjes së detyrave të përcaktuara.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të marrë veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e formimit të komisioneve të merren parasysh parimet për ndarjen e detyrave në mënyrë që zyrtarët të cilët përgatitin specifikimet të mos caktohen në komisionet e vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesat në realizimin e punimeve

Gjetja Në kontratat e nënshkruara ndërmjet MKRS-së dhe operatorëve ekonomik për realizimin e projekteve kapitale përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve sipas kontratës.

Në shtatë⁹ raste, kemi identifikuar se punimet nuk ishin realizuar siç parashihej me kontratë, punimet për këto raste duhej të përfundonin në vitin 2020, respektivisht në vitin 2021. Deri në përfundim të auditimit këto projekte nuk ishin finalizuar (mars 2022).

Vonesat variojn nga tre (3) muaj deri 16 muaj.

Arsyeja e vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte planifikimi jo i mirë i tyre si dhe mungesa e buxhetit.

Ndikimi Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MKRS të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktoj vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi B7 Ministri duhet të bëj një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave, si dhe të rishikoj disponueshmërinë e fondeve kundrejt punimeve të kontraktuara. Në të kundërtën, nuk duhet të nënshkruhen kontrata pa sigurimin paraprak të fondeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 54,124,058€, pasurive jokapitale është 211,403€, si dhe e stoqeve 20,465€.

Çështja B8 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë si dhe mungesa e formimit të komisionit të vlerësimit të pasurisë

Gjetja

Neni 19 paragrafi 4.3 e rregullores Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”, si dhe neni 20 përcakton se “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiare për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës”. Me tutje, sipas nenit 21, Komisioni për Vlerësim e Pasurisë jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga ZKA i organizatës buxhetore.

Në MKRS është bërë inventarizimi i pasurisë për vitin 2021, komisioni ka përpiluar një raport gjithëpërfshirës mirëpo nuk ka bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël. Për më tej, ZKA nuk kishte formuar komisionin për vlerësimin e pasurisë për vitin 2021.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive.

Ndikimi

Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi B8

Ministri duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁰	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	34,905,708	35,547,521	32,632,436	25,583,740	30,917,976
Grante Qeveritare – Buxheti	30,847,318	35,289,014	32,532,239	23,555,254	23,956,313
Të bartura nga viti i kaluar	0	15,539	9,148	15,373	7,283
Të hyrat vetanake	58,390	58,390	8,091	10,378	10,590
Te hyrat nga AKP-ja	4,000,000	0	0	1,988,892	6,819,537
Donacionet vendore	0	3,898	0	509	14,443
Donacionet e jashtme	0	180,681	82,958	13,333	109,809

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 641,814€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2021 MKRS ka shpenzuar 92% të buxhetit përfundimtar ose 32,632,436€, me një përmirësim prej 23% në krahasim me vitin 2020.

Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	34,905,708	35,547,521	32,632,436	25,583,740	30,917,976
Pagat dhe mëditjet	4,990,615	5,035,030	4,968,085	5,074,725	5,052,780
Mallrat dhe shërbimet	1,783,635	3,278,160	2,818,240	1,571,340	1,822,793
Komunalitë	404,908	329,165	278,081	240,436	297,456
Subvencionet dhe transferet	9,716,550	16,862,356	15,439,950	11,157,716	11,432,739
Investimet Kapitale	18,010,000	10,042,810	9,128,081	7,539,522	12,312,208

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 44,415€, për shkak të buxhetit të grandeve të donatorëve në vlerë 95,642€, vendimit të Qeverisë nr.10/46 të datës 30.11.2021 në vlerë 18,000€, si dhe ishte zvogëluar sipas vendimit të Qeverisë nr.11/52 të datës 29.12.2021 për harmonizimin e pagave në vlerë 69,227€. Shpenzimet ishin 99% e buxhetit;
- Buxheti për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar, kishte rritje për 1,494,525€, si rezultat i transfereve nga kategoria e subvencioneve në vlerë 317,550€, me rishikim të buxhetit për vlerën 902,860€, të hyrat e bartura nga viti 2020 në vlerë 15,539€, Grandet e Përcaktuara të Donatorëve në vlerë 78,427€, Ndarje sipas Vendimit të Qeverisë Nr.10/46 i datës 30.11.2021 në vlerë 971,000€ , ndërsa më vendime të qeverisë për kursime ishte zvogëluar për 790,851€. Në këtë kategori ishin shpenzuar 86%;
- Buxheti i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 75,743€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për vlerën 75,768€ ndërsa nga grandet e përcaktuara të donatorëve ishte rritur për vlerën 25€. Shpenzimi ishte 84% e buxhetit;
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 7,145,806€. Buxheti kishte rritje si rezultat i rishikimit buxhetor, ndarjeve me Vendime të Qeverisë, grandeve të përcaktuara të donatorëve si dhe Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike sipas Vendimit të Qeverisë nr.04/69 i datës 15.03.2021 në vlerë 8,058,018€. Ndërsa ishte zvogëluar si rezultat i Vendimeve të Qeverisë për kursime si dhe transfereve nga kjo kategori tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve për 912,212€. Shpenzimet ishin 92% e buxhetit;
- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 7,967,190€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për vlerën 1,603,485€, si dhe me vendime të qeverisë nr.10/46 i datës 30.11.2021, nr.21/50 i datës 23.12.2021 dhe nr.11/52 i datës 22.12.2021 ishte zvogëluar për vlerën 6,702,390€, ndërsa me vendimet e qeverisë nr.02/48 i datës 15.12.2021 ishte rritur në vlerë prej 338,685€. Shpenzimi i buxhetit në këtë fushë ishte 91%.
- Shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID 19 nga ministria ishin në vlerë prej 5,174,301€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2021 ishin në vlerë 58,412€. Këto të hyra janë realizuar nga Arkiva Shtetërore 16,672€, nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë Prizreni 7,528€, Biblioteka Kombëtare e Kosovës 3,884€, Teatri Kombëtar i Kosovës 5,044€, Kosova Film 397€, Kinematografia e Kosovës 3,600€ si dhe të hyrat nga viti i kaluar 21,287€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e biletave për shfaqje, koncerte, pëlqime etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	22,828	22,828	58,412	27,680	64,871
Të hyrat jo tatimore	22,828	22,828	37,125	27,205	56,673
Të hyrat tjera	0	0	21,287	475	8,198

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të MKRS ka rezultuar në 18 rekomandime. MKRS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishte në

proces dhe tetë (8) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar mangësitë e njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë një bashkëpunim efektiv me Ministrinë e Financave për të siguruar që pagesat realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas kërkesave të rregullores në përputhje me planin kontabël.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar mangësitë e njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që me rastin e përgatitjes së PVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për obligimet e papaguara.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë veprimet për të gjitha avanset e pa arsyetura që nga viti 2010 deri në fund të vitit 2019, t'i arsyetojnë dhe mbyllin ato me zyrën e financave. Në rast se nuk i posedojnë dëshmitë e duhura për arsyetimin e tyre, atëherë të kthehen paratë në buxhetin e	Gjatë vitit 2021 Ministria kishte arritur të mbyllë një pjesë të avanseve që ishin bartur nga vitet paraprake.	Pjesërisht i zbatuar

		ministrisë. Në të kundërtën, të ushtrojë padë gjyqësore kundër të gjithë personave për kthimin e këtyre parave.		
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta adresoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë, po përsëritet për vite me radhë dhe asnjë masë drejt zgjidhjes nuk është ndërmarrë.	Sa i përket zyrtarëve të Mbrojtjes Civile në MKRS dhe ASHAK, gjendja nuk ka ndryshuar, pra vazhdon të jetë e njëjtë si vitet e mëparshme.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.	Ende ministria nuk kishte ndërmarrë masat e nevojshme për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar mangësitë e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Baza për konkluzion	Ministri të siguroj që janë vendosur kontrole adekuate të cilat konfirmojnë saktësinë dhe rregullsinë e implementimit të projekteve në mënyrë që çdo projekt të implementohet sipas kushteve të kontratës. Njëherit të siguroj që kërkesat ligjore lidhur me aneks kontratat aplikohen në mënyrë strikte.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet t'i rishikoj rastet e mësipërme dhe t'i ndalojë pagesat pa një bazë të qartë ligjore, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të iniciojë zhvillimin e një politike të rreth funksionimit të këshillave drejtuese dhe komisioneve duke specifikuar në mënyrë të qartë udhëzimet rreth angazhimit, punës dhe kompensimit të anëtarëve të këshillave e dhe komisioneve të ndryshme.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
11.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurohet se respektohen të gjitha kriteret e	Nuk kemi identifikuar çështje	I zbatuar

		përcaktuara në memorandumit e bashkëfinancimit të Federatave dhe të përcaktohet mënyra e subvencionimit në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara nga federatat. Gjithashtu të siguroj se vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren para realizimit të projekteve duke përcaktuar edhe kthimin e mjeteve nga federatat për pjesën e mjeteve financiare të cilën nuk kanë arritur të arsyetojnë me dokumente, në përputhje me kërkesat e memorandumit dhe rregullores për subvencionim.	të ngjashme.	
12.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që secili vendim për subvencionim do të jetë konform kërkesave të rregullores. Për më tepër, ministri duhet të inicioj rishikimin e rasteve të përmendura më lartë për të parandaluar subvencionimin e dyfishtë për projektin e njëjtë.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
13.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri në koordinim me Kryeshëfin duhet të sigurojnë që për secilën procedurë të prokurimit të përcaktoj menaxherin e kontratës në përputhje me kërkesat e ligjore.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
14.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurojë kontrolle në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për nënshkrimin e kontratës sipas kërkesave ligjore.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
15.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet filmike të subvencionuara realizohen dhe arsyetohen në përputhje me kushtet e kontratës dhe kritereve të përcaktuara në rregullore. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve apo vonesave në realizim të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me kontratat përkatëse.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
16.	Investimet kapitale	Ministri duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave, si dhe të rishikoj disponibilitetin e fondeve kundrejt punimeve të kontraktuara. Në të kundërtën, nuk duhet të nënshkruhen kontrata pa sigurimin paraprak të fondeve.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar pa rregullësi të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
17.	Çështjet përbashkëta	Ministri dhe Kryeshëfi i ASHAK-ut duhet të sigurojnë se nënshkrimi i kontratave bëhet vetëm pasi janë respektuar plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe se para fillimit të procesit të prokurimit të sigurohet se fondet e buxhetuara janë të mjaftueshme për mbylljen e aktiviteteve të prokurimit.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
18.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të kryej të gjitha regjistrimet e fundvitit dhe të bëjë	MKRS nuk i kishte ndërmarr hapat e nevojshëm për të	Nuk ka filluar zbatimin

		krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të sqaroj të gjitha diferencat. Dhe vetëm pas harmonizimit të regjistrave, ta paraqes gjendjen e pasurive në PVF.	siguruar se regjistri i pasurive është i plotë dhe i sakt për shkak se gjatë testimit kemi vërjetur se ekzistojnë pasuri të cilat nuk janë regjistruar në regjistra.	
--	--	--	--	--

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Lidhur me këtë, kemi identifikuar si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> Për projektin “Kisha katolike në Ferizaj” fillimisht ishte aplikuar procedura e hapur e prokurimit, pas ankesave nga operatorët ekonomik sa i përket kriterëve të vendosura, KRPP-ja kishte dhënë rekomandim për ndryshimin e këtyre kriterëve. Përkundër që Ministria kishte ndryshuar kriteret ky aktivitetit ishte anuluar me datën 22.11.2021. Më tutje, ministria kishte vazhduar me procedurë të negociuar e cila ka rezultuar me lidhjen e kontratës me datë 23.12.2021 në vlerë 473,363€, duke u thirrur në nevojën për riparime urgjente në këtë objekt. Megjithatë ministria nuk ka ofruar ndonjë dëshmi (procesverbal apo raport) nga komisioni përkatës/Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore i cili ka bërë verifikimin e gjendjes faktike dhe ka konstatuar nevojën për riparime emergjente. Po ashtu tek dy projekte[*] gjatë ekzekutimit të kontratave ishte paraqitur nevoja për punë shtesë të cilat e kanë tejkaluar 10% të vlerës së kontratës bazë. MKRS për këto dy projekte kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit duke përdorur procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë dhe kishte lidhur kontratë me operatorët e njëjtë. 	<p>Ministria nuk pajtohet me këtë gjetje për arsye si me poshtë: Shkresa drejtua KRPP-se (nr.4466/2021 dt. 18.11.2021) që arsyeton plotësisht përdorimin e procedurës se negociuar pa publikim. Sa i përket ndryshimit të procedurës, e njëjta është ndryshuar duke respektuar Ligjin për Prokurim Publik pasi një e tillë e mëparshme ishte anuluar paraprakisht në një fazë të caktuar të procedurës (pas ankesave) kur LPP e lejon një gjë të tillë. Inicimi i procedurës me negociim në këtë rast dhe në rastet tjera ka pasur për bazë përfshirjen asetit në listën me potencial te rrezikut dhe krejt kjo është bërë duke respektuar nenin 35 të LPP bashkëlidhur me nenin 6 paragrafi 12 te Ligjit për Trashëgimi Kulturore, i cili qartazi thotë (perifrazim te cilin mund ta verifikoni) se kur një monument ose aset i TK gjendet në kushtet e rrezikut të shkatërrimit të vlerave ose të demolimit, ai i nënshtrohet një procedure riparimi urgjente ose emergjente. Në këtë mënyrë, konstatojmë se procedura me emergjente ose me urgjente, është kjo që është aplikuar me këtë rast.</p>	<p>Ministria nuk ka përcjellë dëshmi përkatëse sa i përket nevojës për ndërhyrje/riparim emergjent në objektin në fjalë që do të arsyetonin përdorimin e procedurës së negociuar. Për më tepër Ministria në shkresën drejtuar KRPP-së nuk ju është referuar këtij rasti.</p> <p>Prandaj çështja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹², duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 *Fushat ndihmese vlera 178,930€, Renovimi i stadiumit Adem Jashari në Mitrovicë vlera 796,020€, Renovimi i objektit, arkivi ndërkomunal Pejë (dy pagesa) vlera 19,772€; si dhe Harduer për TI – BKK vlera 5,563.2€.
*Stadiumi i qytetit Podujevë - vlera 420,266.28€; Ndërtimi i qendrës nacionale të xhudos në Pejë – vlera 42,880€, si dhe Ndërtimi i qendrës së kulturës në Vushtri – vlera 13,740.82€.
- 5 Pagesa në vlerë 4,469€ angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm profesional në fushën e trashëgimisë dhe kulturës; pagesa në vlerë 11,959€ për anëtarë të jashtëm të komisioneve të ndryshme; si dhe pagesa në vlerë 4,660€ për blerjen dhe botimin e librave për bibliotekë.
- 6 Kontrata "Ndërtimi i Stadiumeve Ndihmëse në Gjilan, Pejë, Drenas dhe Studençan", si dhe kontrata "Intervenimet emergjente në regjionin e Gjilanit".
- 7 Veprimtari primare ka aktivitetet tjera botuese.
- 8 Përfituesit: KBSH me vlerë 1,640 data e nënshkrimit të kontratës 18.12.2020, periudha e zbatimit 3 muaj. Përfituesit: OJQ Instituti për Integrimin e Rinise me vlerë 2,500, data e nënshkrimit të kontratës 27.07.2021, periudha e zbatimit 3 muaj Përfituesit: OJQ Puzzle for Autizem me vlerë 5,200 data e nënshkrimit të kontratës 17.08.2020, periudha e zbatimit gjatë vitit 2020. Përfituesit: Hani i 2 Robeve me vlerë 4,000, data e nënshkrimit të kontratës 30.12.2020, periudha e zbatimit 15.06.2021. Përfituesit: FEKT me vlerë 7,000, data e nënshkrimit të kontratës 28.07.2020, periudha e zbatimit gjatë vitit 2021. Përfituesit: OJQ Skenderaj live me vlerë 7,350, data e nënshkrimit të kontratës 27.07.2021, periudha e zbatimit 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës Përfituesit: OJQ ACCESS me vlerë 13,456, data e nënshkrimit të kontratës 23.07.2021, periudha e zbatimit 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës
- 9 - Stadiumi i qytetit Gjilan vlera e kontratës 3,121.346€, duhej te përfundonte me 23.10.2020, ndërsa në muajin tetor 2020 ishte bërë amendamenti i kontratës ku janë paraparë ndryshime në punët që duhet kryer pa paraparë kohën e kryerjes dhe aspektin financiar të ndryshimeve nga kontrata bazë, ndërsa me datën 07.09.2021 ishte bërë përsëri amendamenti i kontratës ku afati për përfundimin e kontratës zgjatet deri me datën 30.12.2022; - Renovimi i shtëpisë së kulturës Viti- vlera e kontratës 248,605.55€, e nënshkruar me datën 19.10.2017, kontratë dy vjeçare, me vendim mbi vazhdimin e afatit kohor të kontratës është vazhduar dy herë, ku përfundimi i punimeve duhet të bëhet me datën 31.12.2021. - Ndërtimi i qendrës së kulturës në Rugovë të Hasit, Komuna e Gjakovës- vlera e kontratës 999,210.08€ e nënshkruar me datën 22.02.2018 përfundimi i punëve do të duhej të bëhej brenda tri viteve, por ende nuk kishte përfunduar. - Rivitalizimi i stadiumit në Pozharan Viti vlera e kontratës 419,419.10€, e nënshkruar me datën 27.12.2017, kontratë dy vjeçare, me vendim mbi vazhdimin e afatit kohor të kontratës është zgjat afati deri me datën 31.12.2021. - Renovimi i stadiumit Adem Jashari në Mitrovicë vlera e kontratës 12,394,800€, e nënshkruar me datën 16.06.2019, kontratë dy vjeçare, pastaj me amendamentim të kontratës është zgjat afati deri me 16.06.2023. - Ndërtimi i sallës Sportive Gremë- Ferizaj vlera e kontratës 1,195,727.24€, e nënshkruar me datën 08.08.2018, kontratë tri vjeçare, pastaj me aneks kontratë është zgjat afati deri me 08.08.2022. - Pishinës Olimpikë Prizren vlera e kontratës 2,499,750.30€, e nënshkruar me datën 24.04.2018, kontratë tri vjeçare, por ende nuk kishte përfunduar.
- 10 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 11 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 12 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.